



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 506 Akti

Nr. 380 Vendimi  
Tiranë, më 4.5.2021

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Suela Zhegu</b>	Kryesuese
<b>Alma Faskaj</b>	Relatore
<b>Etleda Çiftja</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 4.5.2021, mori në shqyrtim çështjen që i përket,

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Martin Deda**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Aneksi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 842016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Martin Deda, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë deri në datën 23.1.2021, datë në të cilën ka ndërruar jetë.
2. Me vendimin nr. 1, datë 20.6.2020, trupi gjykues shprehu mospasjen e konfliktit të interesit, si dhe caktoi kryesuesin e tij.
3. Në datën 25.11.2020, subjektit të rivlerësimit iu dërguar përbërja e trupit gjykues dhe pyetësori standard, si dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit.
4. Komisioni mori dijeni nga burime mediatike se subjekti i rivlerësimit, z. Martin Deda, ka ndërruar jetë. Në këto kushte Komisioni iu drejtua me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2021, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për të na vënë në dispozicion certifikatën e vdekjes së të ndjerit Martin Deda.
5. Më shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile informon Komisionin se z. Martin Deda ka ndërruar jetë në datën 23.1.2021, duke bashkëlidhur dhe certifikatën e vdekjes së tij.

#### **ARSYETIMI I KOMISIONIT**

6. Subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
7. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Martin Deda, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka dërguar dhe plotësuar, si vijon:
  - a. deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31 të tij;
  - b. deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35 të tij;
  - c. formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 41 të tij.
8. Komisioni, pas fillimit të procedurës së rivlerësimit në kushtet kur subjekti ka ndërruar jetë, çmon se duhet të përfundojë këtë procedurë pa një vendim përfundimtar në bazë dhe për zbatim të nenit 90, pika 3, të ligjit nr. 44/20151, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi*”, dhe të nenit 93, ku parashikohet: “*Nëse pala, person fizik, vdes*

*gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen”.*

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, bazuar në nenet 9 dhe 93 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 57 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 94/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për subjektin Martin Deda.
  2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
  4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 4.5.2021.

### **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Suela ZHEGU**  
**Kryesues**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Anëtar**

**Alma FASKAJ**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*